

KËRKESË
Nr. 2469, datë 1.8.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“SHPRESA HALIT”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“SHPRESA HALIT”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000552-5

Datë: 18.7.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPUT-TR-2019-000552-2 , datë 5.7.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Shpresa Halit, me NIPT L61614011H, përfaqësues i autorizuar i subjektit Z. Renea Shqau, me ID: I80328018G, punetor, prej datës 5.7.2019, ora 14:00 deri më datën 5.7.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datën 5.7.2019 dhe e njoftoi më datën 5.7.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29, pika 1/b/iii,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënime administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Propozim për revokim leje mjedisore sipas ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 27, pika b dhe pezullim plotësisht të aktivitetit.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

15.7.2019 - 1. Të dorëzojë pranë ISHMPUT-së, Tiranë, vetmonitorimin periodik çdo 6 muaj të protokolluar pranë ARM-së, Tiranë, përpara datës së inspektimit duke qenë se subjekti pretendon se i dispon.

2. Të dorëzojë pranë ISHMPUT-së, Tiranë, pagesën vjetore.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Besmir Stafa ID: ____

Arjan Cela ID: ____

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti “Shpresa Halit” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.